



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, në datën 23 shkurt 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e bilancit vjetor të AMA-s për vitin 2020. (**Vendimi nr. 30, datë 23.02.2021**)
2. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “APT Cable” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV kabllor APT”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit në Bashkinë Sarandë. (**Vendimi nr. 31, datë 23.02.2021**)
3. Pajisjen e shoqërisë “Vani” sh.p.k., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv Mati”, për të ofruar shërbim në qarkun Dibër. (**Vendimi nr. 32, datë 23.02.2021**)
4. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Hajri Hoxha, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor HB-CA”. (**Vendimi nr. 33, datë 23.02.2021**)
5. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Ora News”. (**Vendimi nr. 34, datë 23.02.2021**)

AMA në këtë mbledhje u njoh me angazhimin e deritanishëm të Autoritetit të Mediave Audiovizive në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor.

AMA, në këtë mbledhje mori në shqyrtim relacionin dhe projektvendimin “Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Mediave Audiovizive” dhe ra dakord t’a rimarrë në shqyrtim këtë projektvendim në mbledhjen e tij të radhës.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 23.02.2021